

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Joint Stock Companies  
Trepça Deonçarsko Društvo

Nr. 2052 Data. 13.04.2023  
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonçarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



**RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KOHËZGJATJES SË  
PUSHIMIT VJETOR NË BAZË TË VLERËSIMIT TË  
RREZIKSHMËRISË NË TREPÇA SH.A**

Mitrovicë, më 31.03.2023

Trepça

## PËRMBAJTJA

1. Qëllimi	2
2. E drejta për pushim vjetor me shtesë të plotë	2
3. E drejta për pushim vjetor me shtesë jo të plotë 7 ditë	3
4. E drejta për pushim vjetor me shtesë jo të plotë 5 ditë	3
5. E drejta për pushim vjetor me shtesë jo të plotë 3 ditë	4
6. Dispozitat përfundimtare	4

Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi i Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2023, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KOHËZGJATJES SË PUSHIMIT VJETOR NË BAZË TË VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË NË TREPÇA SH.A**

### **Neni 1 Qëllimi**

1.Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e kohëzgjatjes të pushimit vjetor në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë në punë që përkundër aplikimit të masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme.

2.Duke u bazuar ne Ligjin e Punës Nr 03/L-212 të nenit 32 pika 3 i punësuarit i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat përkundër aplikimit të masave mbrojtëse ,nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetorë në kohëzgjatje se paku 30 ditë pune të vitit kalendarik.

### **Neni 2**

#### **E drejta për pushim vjetor me shtesë të plotë**

1.I punësuarit i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat përkundër aplikimit të masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor si dhe shtesë dhjetë (10) ditë pune, për vitin kalendarik. Këtë te drejtë në ndërmarrjen Trepça Sh.A e kanë punëtorët në këto pozita:

- Xehetarët
- Ndihmës Xehetarët
- Lloderistat
- Toristat
- Ngarkuesit e skipit

### Neni 3

#### E drejta për pushim vjetor me shtesë jo të plotë 7 ditë

1. I punësuar i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat ekziston rrezikshmëria por me aplikimin e masave mbrojtëse mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor si dhe shtesë shtatë (7) ditë pune, për vitin kalendarik. Këtë të drejtë në ndërmarrjen Trepça Sh.A e kanë punëtorët në këto pozita:

- Thermimi (Flotacion)
- Reagensat (Flotacion)

### Neni 4

#### E drejta për pushim vjetor me shtesë jo të plotë 5 ditë

1. I punësuar i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat ekziston rrezikshmëria por me aplikimin e masave mbrojtëse mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor si dhe shtesë pesë (5) ditë pune, për vitin kalendarik. Këtë të drejtë në ndërmarrjen Trepça Sh.A e kanë punëtorët në këto pozita:

- Vozitësit e kamionit
- Vozitësit e lokomotivës
- Binaristat
- Latuesit
- Gyptarët
- Punëtor te pakualifikuar
- Muratorët
- Hidrombushja
- Hiri
- Shpimet e thella
- Transporti
- Transporti 610
- Ajrimi
- Mbikëqyrës (Prodhimit, Hidrombushja, Transporti, Muratorët, Shpimet e thella)
- Axhustratorët e lloderit
- Personeli teknik i prodhimit dhe mbushjes
- Personeli Teknik Mbikëqyrës elektro- makineri
- Automekanikët.

## Neni 5

### E drejta për pushim vjetor me shtesë jo të plotë 3 ditë

1. I punësuar i cili punon në punët dhe detyrat e punës për të cilat ekziston rrezikshmëria por me aplikimin e masave mbrojtëse mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor si dhe shtesë tri (3) ditë pune, për vitin kalendarik.

Këtë të drejtë në ndërmarrjen Trepça Sh.A e kanë punëtorët në këto pozita:


- Prodhimi në Flotacion.

## Neni 6

### Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë në Trepça Sh.A, hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet prej ditës së publikimit në web-faqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A



Dr.Sc. Bahri Hyseni

